



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E FINANANCAVE DHE
EKONOMISË
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E
TATIMEVE

Nr. 6250 Prot.

Tiranë, më 25.3.2019

KRYEMINISTRIA
AGJENCIA E OFRIMIT TË
SHËRBIMEVE PUBLIKE TË
INTEGRUARA (ADISA)

Nr. 394 Prot.

Tiranë, më 25.03.2019

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
LIDHUR NDËRMJET
PALËVE

Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (në vijim DPT), me seli në adresën: Rr. "Gjin Bue Shpata" (pas Stadiumit "Selman Stërmasi") Tiranë, e cila është autoriteti tatimor qendror i vetëm në Republikën e Shqipërisë, që zbaton dhe administron tatimet kombëtare, pagesat publike dhe mbledhjen e kontributeve dhe funksionon në bazë të Ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar, **përfaqësuar nga Drejtori i Përgjithshëm, Znj. Vasilika Vjero**

DHE

Agjencia e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (në vijim ADISA), me seli në adresën: Bulevardi "Zhan D'Ark", i cili është një institucion publik, që është ngritur dhe funksionon në bazë të Ligjit Nr. 13/2016, datë 18.02.2016 "Për mënyrën e ofrimit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë", **përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, Z. Lorin Ymeri**

Palët, së bashku bien dakord të nënshkruajnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi (këtu e më poshtë referuar si "**Marrëveshja**"), si më poshtë vijon:

Neni 1

Objekti i Marrëveshjes

Në Marrëveshje midis tyre, palët bien dakord që brenda ambienteve të *Qendrës së Integruar për Ofrimin e Shërbimeve Publike në Shkodër (në vijim QENDRA)*, e cila administrohet nga ADISA, Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër do t'i vihen në

dispozicion 2 (dy) sportele të dedikuar, për ofrimin e shërbimeve të saj dhe 1 (një) post pune për përgjegjës. Këto shërbime ofrohen nga Drejtoria Rajonale Tatimore Shkodër, e cila është krijuar dhe funksionon në bazë të ligjit Nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë" i ndryshuar.

Neni 2

Baza Ligjore

2.1 Për lidhjen dhe zbatimin e kësaj marrëveshje, palët i referohen dhe mbështeten mbi bazën ligjore si më poshtë:

- Nenet 119 dhe 121 të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar;
- Nenet 901 e vijues të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar;
- Ligji Nr. 13/2016, datë 18.02.2016 "Për mënyrën e ofrit të shërbimeve publike në sportel në Republikën e Shqipërisë";
- Ligji Nr. 9920, datë 19.05.2008, "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.

Neni 3

Afati i Marrëveshjes

- 3.1 Afati i kësaj Marrëveshje është 2 (dy) vjet dhe fillon nga data e nënshkrimit të saj nga palët me të drejtë rinovimi.
- 3.2 Ky afat mund të ndryshohet përmes një marrëveshje me shkrim midis palëve.
- 3.3 Marrëveshja rinovohet automatikisht për një periudhë kohe të pacaktuar, nëse asnjëra nga palët nuk njofton me shkrim palën tjetër për përfundimin e saj, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë para përfundimit të afatit të përcaktuar sipas pikës 3.1 të këtij neni.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve

- 4.1 Me nënshkrimin e kësaj Marrëveshje, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve merr përsipër:
- 4.1.1 Të transferojë 2 (dy) sportelet e shërbimit ndaj tatimpaguesve në Shkodër dhe postin e punës së përgjegjës të tyre, nga ambientet ku janë të vendosura aktualisht, në ambientet e QENDRËS të vëna në dispozicion nga ADISA pa kundërshtim.
- 4.1.2 Të bëjë të mundur funksionimin e sistemit të DPT-së të nevojshëm për ofrimin e shërbimeve të saj në sportelet e QENDRËS.
- 4.1.3 Të vërë në dispozicion nëpunësve, që do të vendosen në sportelet/postet e punës, në përdorim brenda QENDRËS, të cilët duhet të respektojnë tërësinë e

rregullave për etikën e sjelljes, komunikimit dhe veshjes, sipas standardeve të ofrimit të shërbimeve në sportel.

- 4.1.4 Të pranojë ankesat e administruara nga punonjësit e ADISA-s pranë Qendrës ,në lidhje me cilësinë e shërbimit ndaj tatimpaguesve. Ankesat duhet të shqyrtohen brenda një afati ligjor, duke marrë masat e nevojshme për rivendosjen e situatës, nëse paraqiten fakte dhe argumente të justifikuara;
- 4.1.5 Të ushtrojë të gjitha detyrat operationale të ngarkuara mbështetur në ligjin Nr. 9920, datë 19.05.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe kuadrin ligjor në fuqi që rregullon veprimtarinë e saj, në hapësirën e caktuar ashtu si janë ushtruar edhe përpara nënshkrimit të kësaj Marrëveshje.
- 4.1.6 Të mirëmbajë të gjitha mobilitet, pajisjet dhe mjetet e tjera të dhëna në përdorim nga ADISA gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes dhe t’i dorëzojë ato në gjendje pune në momentin e përfundimit të Marrëveshjes.
- 4.1.7 Të kujdeset për mirëmbajtjen e ambienteve të marra në përdorim deri në kthimin e tyre në përfundim të Marrëveshjes.
- 4.1.8 Të zbatojë standardet e vendosura nga ADISA, lidhur me ofrimin e shërbimeve në sportel si dhe rregulloret e brendshme të ADISA-s të miratuara për këtë qëllim.

Neni 5

Të drejtat dhe detyrimet e ADISA

- 5.1 ADISA merr përsipër që gjatë gjithë kohëzgjatjes së Marrëveshjes t’i vërë në dispozicion pa kundërshtim Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër), ambientet për funksionimin e 2 (dy) sporteleve, të branduara nga ADISA dhe 1 (një) post pune për përgjegjësin, të mobiluara (post pune i kompletuar me tavolinë, karrige, raft) dhe pajisjet e nevojshme IT (kompjuter, printer, skaner, linjë interneti, fotokopje), duke siguruar kushte normale pune dhe akses nga publiku.
- 5.2 Të ofrojë trajnime fillestare dhe periodike mbi rregullat e ofrimit të shërbimeve publike në sportel sipas parimit me në qendër qytetarin (etikën e komunikimit, modelet e sjelljes, menaxhimit të situatave problematike etj.) me qëllim përgatitjen e tyre për të ofruar shërbimin në mënyrë sa më të shpejtë dhe cilësore për qytetarin;
- 5.3 Të sigurojë sistemin e menaxhimit të radhës, në mënyrë elektronike dhe të përbashkët për të gjitha sportelet e QENDRËS, përfshirë këtu dhe sportelin e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër).
- 5.4 Të sigurojë informacion për publikun nëpërmjet sportelit të informacionit në lidhje me shërbimet e ofruara nga sportelet e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër.
- 5.5 Të mbledhë dhe administrojë ankesat e qytetarëve në lidhje me cilësinë e shërbimit të ofruar nga nëpunësit e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër dhe t’ia përcjellë me shkrim për trajtim kësaj të fundit.

- 5.6 Të marrë në dorëzim në përfundim të Marrëveshjes ambientet e dhëna në përdorim, mobiliet dhe pajisjet në gjendjen që i ka dorëzuar, duke konsideruar amortizimin normal të tyre.

Neni 6

Nëpunësit e sportelit, të drejtat dhe detyrimet e tyre

- 6.1 Nëpunësit e sportelit dhe përgjegjësi janë nëpunës të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve (Drejtorisë Rajonale Tatimore Shkodër), të emëruar në bazë të legjislacionit në fuqi dhe kontratave të punës.
- 6.2 Marrëdhënia e tyre e punës mbetet në fuqi dhe nuk transferohet te ADISA gjatë të gjithë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshje.
- 6.3 ADISA nuk ka detyrime financiare ndaj nëpunësve të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, të cilët do të ushtrojnë detyrat e tyre brenda hapësirave të QENDRËS.
- 6.4 Nëpunësit e sportelit dhe përgjegjësi që do të ofrojnë shërbimet ndaj tatimpaguesit pranë QENDRËS, respektojnë tërësinë e standardeve të vendosura nga ADISA për ofrimin e shërbimeve në sportel.
- 6.5 Në rast shkelje të rregullave dhe standardeve të ofrimit të shërbimeve nga nëpunësit e sportelit, përfshirë edhe ata të nivelit drejtues, të evidentuar gjatë monitorimit apo në çdo formë tjetër të përshtatshme, palët njoftojnë menjëherë njëra tjetrën me qëllim marrjen e masave disiplinore ndaj nëpunësve përkatës;
- 6.6 Titullari i ADISA-s propozon zëvendësimin e nëpunësit, nëse ky i fundit nuk kryen detyrën sipas rregullave të ofrimit të shërbimeve në sportel. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve (Drejtorija Rajonale Tatimore Shkodër) verifikon bazueshmërinë e propozimit dhe njofton Titullarin e ADISA-s për masat e marra.

Neni 7

Shpenzimet për funksionimin e sporteleve

- 7.1 Shpenzimet për funksionimin e Sporteleve/posteve të punës përballohen nga fondet e DPT dhe mbulojnë shpenzimet për pagat, sigurime shoqërore dhe shëndetësore për nëpunësit e sportelit, si dhe shpenzimet operative (bojë për pajisjet, letër, kancelari etj.) për mirëfunksionimin e sporteleve të shërbimit.
- 7.2 ADISA merr përsipër të sigurojë vënien në dispozicion të posteve të punës brenda ambienteve të QENDRËS, të pajisura me mobilie, pajisje IT dhe furnizim me internet, siç është përcaktuar në nenin 5/1. Këto pajisje jepen në përdorim gjatë kohëzgjatjes së Marrëveshjes, por mbeten në pronësi të ADISA, e cila merr përsipër edhe amortizimin normal të tyre.

Neni 8

Orari i funksionimit të sportelit

- 8.1 Orari i pranimit të aplikimeve për sportelin është:
E hënë - E premte ora 08:00 - 15:00
- 8.2 Orari gjatë të cilit ambientet e ADISA-s mund të përdoren nga nëpunësit e Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër, sipas kësaj Marrëveshje është 08:00-16:30, nga e hëna deri të premte.
- 8.3 Përgjegjësi i sporteleve të QENDRËS do të raportojë për paraqitjen e nëpunësve të Drejtorisë Rajonale të Tatimeve Shkodër çdo ditë zyrës së burimeve njerëzore të saj.

Neni 9

Shkëmbimi i informacionit dhe i dokumentacionit

- 9.1 Procesi i aplikimit në sportel do të bëhet në bazë të rregullimeve ligjore/nënligjore/kontraktuale në fuqi për ofrimin e shërbimeve të DPT-së dhe Ligjit 13/2016 “Për ofrimin e shërbimeve publike në sportel në RSH” për aq sa ky i fundit nuk bie në kundërshtim me rregullimet ligjore aktuale për ofrimin e këtyre shërbimeve.
- 9.2 Me kërkesë të ADISA-s, Drejtoria Rajonale e Tatimeve Shkodër i vë në dispozicion kësaj të fundit raporte në lidhje me aplikimet dhe afatet e përgjigjeve.
- 9.3 Drejtoria e Përgjithshme të Tatimeve vë në dispozicion punonjësit të info-point të ADISA, pranë QENDRËS materiale informuese të saj, si broshura dhe informacione të tjera në lidhje me aplikimin dhe ofrimin e shërbimeve përkatëse.

Neni 10

Zgjidhja e Marrëveshjes

- 10.1 Marrëveshja përfundon me përfundimin e afatit të përcaktuar në nenin 3 të saj.
- 10.2 Marrëveshja mund të zgjidhet përpara afatit me kërkesë të ADISA-s, nëse DPT:
- Nuk respekton kushtet e marrëveshjes;
 - Nuk e përdor ambientin/postet e punës sipas destinacionit dhe qëllimit të përcaktuar në këtë Marrëveshje;
 - Keqpërdor, dëmton dhe nuk kujdeset për ruajtjen e ambientit të marrë në përdorim,
 - Për shkaqe të tjera objektive në interes publik.
- 10.3 Marrëveshja mund të zgjidhet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve në rast se nuk janë plotësuar kushtet e nevojshme për ofrimin e shërbimit nga ADISA, si:
- Nuk respektohen kushtet e rëna dakord në këtë marrëveshje;
 - Qëllimi për të cilin ambienti është marrë në huapërdorim nuk ekziston më.
- 10.4 Në të dy rastet e mësipërme Palët kanë të drejtë të zgjidhin këtë marrëveshje duke njoftuar me shkrim jo më vonë se 30 ditë përpara, shkakun/verifikimin e kushteve të mësipërme.

Neni 11
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

- 11.1 Palët bien dakord që çdo mosmarrëveshje që lind ose mund të lindë nga ose gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshje Bashkëpunimi do të zgjidhet me mirëkuptimin midis palëve, në rast të kundërt do të zbatohet legjislacioni në fuqi për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve.

Neni 12
Ndryshime

- 12.1 Kjo Marrëveshje mund të pësojë ndryshime, shtesa dhe/ose zëvendësime vetëm me marrëveshje me shkrim të dy palëve.
- 12.2 Çdo ndryshim i kësaj Marrëveshje apo shtojcave bashkëlidhur, pasi të hyjë në fuqi, do të jetë pjesë përbërëse dhe e pandashme e saj.

Neni 13
Hyrja në fuqi

- 13.1 Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët.

Neni 14
Dispozita të fundit

- 14.1 Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi u hartua në 4 (katër) kopje me vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe dhe secila palë mban 2 (dy) kopje të njëjta.

PALËT


PËR

**DREJTORINË E PËRGJITHSHME
TË TATIMEVE**

**DREJTOR I PËRGJITHSHËM
VASILIKA VJERO**

**NË MUNGESË DHE ME URDHËR
ZV. DREJTOR I PËRGJITHSHËM**

Xhayit ÇURRI



PËR

**AGJENCINË E OFRIMIT TË
SHËRBIMEVE PUBLIKE TË
INTEGRUARA (ADISA)**

DREJTOR EKZEKUTIV

Lorin YMERI

